

2987
07.07.2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIV E APELIT
TIRANË

NR.5635/1203 AKTI

NR.1313 VENDIMI
DT 05.06.2015

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, në trup gjykues të përbërë nga:

Kryesuese: Alkelina Gazidedja

Anëtare: Rilinda Selimi

Anëtare: Blerona Hasa

asistuar nga sekretare gjyqësore Valbona Zenelaj, sot më datë 05.06.2015, shqyrtoi në dhomë këshillimi, çështjen administrative me palë:

PADITËS: "Pupa" SHPK, me qendër në Fushë-Peshtan, Berat.

TË PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Berat.

Drejtoria ne Përgjithshme e Tatimeve Tiranë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i aktit "Njoftimi vleresimi për detyrimin tatimor" nr. 1016 datë 29.03.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat dhe vendimit datë 07.05.2012 të Drejtorisë Apelit Tatimor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 109 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë", nenet 32 dhe 324 K.Pr.Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 1417, datë 22.10.2012 ka vendosur :

- Pranimin e padisë.
- Shfuqizimin e aktit administrativ me titull "Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore" nr. 1016 date 29.03.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat dhe vendimit nr. 9051/1 datë 07.05.2012 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.
- Shpenzimet gjyqësore të kryera nga paditësi "Pupa" SHPK në masën 52200 (pesëdhjetë e dy mije e dyqind) lekë në ngarkim të të paditurit Drejtoria Rajonale Tatimore Berat.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes se këtij vendimi.

I padituri Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit Vlorë, nëpërmjet kërkesës ankimore nr. 3867 prot, datë 06.11.2012 duke kërkuar ndryshimin e vendimit nr.1257, datë 26.09.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Berat dhe përfundimisht rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova e në ligj, për këto shkage:

- Vendimi është rezultat i gabuar i interpretimit të ligjit, pasi neni 55 i ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” përcakton detyrimin e vendosjes fiskale për tatimpaguesit që bëjnë shitje me lekë në dorë dhe jo nëpërmjet bankës.
- Përdorimi, mirëmbajtja dhe regjistrimi i pajisjeve fiskale është parashikuar në Udhëzimi nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” në kreun VI, pika 55 dhe në Vendimin e KM nr.781, datë 14.11.2007, i ndryshuar.
- Pajisja fiskale e instaluar në pikën e biznesit nuk figuron në listën e pajisjeve të certifikuara nga Shoqëria “Pupa”. Sh.P.K., referuar kjo për momentin e kontrollit. Për këtë çështje është dorëzuar një kopje e printuar të faqes zyrtare të internetit DPT Tiranë. Raportet ditore vërtetojnë përdorimin vetjak të aparaturës dhe jo transmetimin on-line në DPT, të transaksioneve ekonomike të kryera. Aparatura e vendosur nga paditësi nuk transmeton të dhënat on-line në DPT dhe kjo penalizon paditësin, pasi sipas VKM nr.781, datë 14.11.2007, të ndryshuar tatimpaguesi duhet të realizojë transmetimin e të dhënave ditore në DPT.
- Tatim paguesi për mungesë të pajisjes fiskale është penalizuar për herë të parë, ndaj dhe gjoha e vendosur nga inspektorët tatimor është e drejtë dhe e bazuar ligjërisht, pasi shkeljes së konstatuar i përputhet dhe penaliteti i vendosur.

Po kështu, Avokatura e Shtetit me shkresën nr.1685 prot., datë 29.05.2015, bazuar në nenet 5/b, 32 i ligjit nr.10018, datë 23.11.2008 “Për avokaturën e Shtetit”, neni 1, pika “d” i Rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me Institucionet shtetërore dhe entet publike, rolit të avokatëve të Shtetit në gjykim si dhe norma të tjera procedurale”, ka deleguar të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes përfqësuesve të institucioneve shtetërore dhe enteve publike.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi dëgjoji relatimin e çështjes nga gjyqtarja Alkelina Gazidedja, shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi

V Ë R E N

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 376, datë 11.03.2014, ka vendosur moskompetencën lëndore dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Apelit Administrativ.

Në këto kushte kjo çështje u gjykua nga Gjykata Administrative e Apelit, në zbatim edhe të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë Nr. 03, Dt.06.12.2013 i cili ka arritur në përfundimin se: *Këto gjykata janë kompetente për çështjet administrative për të cilat padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 04.11.2013, respektivisht në gjykatat e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatë të Lartë dhe deri në këtë datë shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar akoma”.*

Rrethanat e faktit

Nga aktet bashkëngjitur dosjes që i përket vendimit objekt ankimi, rezulton se, paditësi "Pupa" SHPK është person juridik privat i regjistruar ne QKR me seli në Fushë-Peshtan, Berat, me veprimtari tregtare midis të tjerash edhe prodhim të materialit lidhës gëlqere.

Nga ana e te paditurit DRT Berat është nxjerre akti administrativ me titull "Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore" ndaj personit juridik "Pupa" SHPK, me numër 1016 prot., datë 29.03.2012. Me anë të këtij akti administrativ, i padituri DRT Berat ka njoftuar paditesin se duhet të paguajë detyrimin tatimor në masën 200 000 lekë.

Sipas këtij akti administrativ, ky detyrim rrjedh prej denimit me gjobë në masën 200 000 lekë që punonjësit e administratës tatimore kanë vendosur ndaj paditësit. Në këtë akt administrativ është shënuar se gjoba është vendosur ndaj paditsit me procesverbalin e gjobës me numër serie 0062725 datë 26.01.2012 me numër protokolli 1744 datë 21.03.2012 me titull "*Shitje pa kupon tatimor mbajtur nga Task-Forcë*".

Rezulton se nga punonjësit e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë është mbajtur procesverbali me numër serie 0062725 datë 26.01.2012, në të cilin është konstatuar se: "Gjatë kontrollit të ushtruar në transport në aksin Vlorë-Fier u ndalua mjeti me targa "BR 1884B" i cili kishte bërë shitje pa lëshuar kupon tatimor. Nr. serisë së faturës tatimore 00117566". Ky mjet figuron sipas ekstraktit të QKR si mjet në pronësi të paditësit "Pupa" SHPK.

Akti administrativ "*Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore*" me numër 1016 prot. datë 29.03.2012 i është dërguar paditësit me shërbimin postar, sipas vërtetimit datë 07.06.2012 të personit juridik "Posta Shqiptare" SHA. Ky akt i është dorëzuar paditesit "Pupa" SHPK në datën 02.04.2012 dhe paditësi ka ushtruar ankim administrativ tek i padituri Drejtoria e Apelit Tatimore Tiranë në datën 01.05.2012, sipas dërgesës postare me nr. 162587, e cila është protokolluar në këtë të fundit në datë 02.05.2012.

Drejtorja e Apelit Tatimor Tirane me vendimin nr. 9051/1 prot. date 07.05.2012 ka vendosur refuzimin e ankimit si i paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 23 paragrafi, 2 i ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në RSH*". Refuzimi është bërë me arsyetimin se, data 02.05.2015, në të cilin ka mbërritur ankimi në organin më të lartë administrativ, Drejtoria e Apelit Tatimore Tirane, është jashtë afati 30 ditor. Në vendim është shënuar dhe e drejta e ankuesit për të paraqitur padi në gjykatë sipas nenit 109 të ligjit në fjalë brenda afatit 30 ditor nga marrja dijeni e vendimit të sipërcituar.

Duke mos qenë dakort me sa më sipër, shoqëria "Pupa" SHPK, e ka bërë cështjen konflikt gjyqësor, duke kërkuar nëpërmjet kërkespadiisë së saj, shfuqizimin e aktit "Njoftimi vlerësimi për detyrimin tatimor" nr. 1016 datë 29.03.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimeve Berat dhe vendimit datë 07.05.2012 të Drejtorisë Apelit Tatimor Tiranë.

Kolegji administrativ së pari verifikoi kushtin e ezaurimit të ankimit administrativ prej paditësit. Kolegji vlerëson se paditësi e ka ezauruar ankmin administrativ ashtu sikundër me të drejtë e ka konstatuar edhe gjykata e rrethit gjyqësor pasi :

Ankimi i paditësit "Pupa" SHPK ndaj aktit administrativ "Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore" numër 1016 prot. datë 29.03.2012 është ushtruar në përputhje me afatet ligjore të parashikuara në ligj për ankimin administrativ ne nenin 106 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008

“Për procedurat tatimore ne RSH” si dhe ne piken 106.3 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24 date 02.09.2008 i ndryshuar.

Në bazë të akteve ligjore e nenligjore te mesiperme si dhe te rrethanave konkrete te rezultura ne gjykim, konkludohet se paditesi “Pupa” SHPK ka marre ne dorëzim aktin administrativ ne daten 02.04.2012. Pala e paditur Drejtoria e Apelimit Tatimor ne vendimin e saj nr.9051/1 prot. date 07.05.2012 ka arsyetuar se ankimi është marre ne dorëzim nga paditesi “Pupa” SHPK ne daten 29.03.2012. Ky i paditur ka mare ne konsiderate si date te marrjes se njoftimit nga paditesi daten 29.03.2012 pasi ka vlerësuar se dita e marrjes dijeni te paditesit është dita e marrjes ne dorëzim te njoftimit nga shërbimi postar. Por ndonëse akti administrativ “Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore” ndaj personit juridik “Pupa” SHPK, me numer 1016 prot. date 29.03.2012 është dorëzuar ne shërbimin postar date 29.03.2012, vete shërbimi postar e ka nisur kete akt ne daten 30.03.2012 dhe është marre ne dorëzim efektiv nga paditesi ne daten 02.04.2012. Ky fakt vërtetohet nga vërtetimi date 07.06.2012 i Filialit Berat te “Postes Shqiptare” SHA i administruar ne gjykim. Ne interpretim te nenit 106 pika 3 te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 afati 30 ditor për ankim nga personi qe po njoftohet fillon nga dita qe ky njoftim është marre efektivisht e ne mungese te kësaj dite konsiderohet dita kur vlerësohet se njoftimi është marre nga tatimpaguesi. Interpretimi si me sipër vjen ne harmoni dhe me nenin 140 te Kodit te Procedurave Administrative.

Për keto arsye gjykata çmon se numërimi i afatit duhet te kete si reference daten e dorëzimit te dokumentit, daten 02.04.2012.

Ne lidhje me llogaritjen e afatit 30 ditor gjykata çmon se ky afat ne kuptim te nenit 148 te Kodit te Procedurës Civile dhe nenit 91 te Kodit Civil duhet te filloje numërimin e vet nga dita e nesërme e dorëzimit te njoftimit.

Për sa me siper kolegji vlerëson se afati 30 ditor për paditesin “Pupa” SHPK për ankimin e tij ndaj aktit administrativ fillon numërimin e vet ne daten 03.04.2012, duke patur kete date si ditën e pare te afatit. Nisur nga ky fakt, afati 30 ditor llogaritet se përfundon ne daten 02.05.2012. Data 02.05.2012 llogaritet si dita e 30-te e këtij afati.

Paditesi “Pupa” SHPK e ka dorëzuar ankimin e vet ne shërbimin postar ne daten 01.05.2012, sipas dokumentit postar te administruar ne gjykim te siperpermendur e për rrjedhim data 01.05.2012 llogaritet si dita e 29-te e këtij afati pra si ditë brenda këtij afati 30 ditor. Edhe nese do te numërohej dita e dorëzimit efektiv te aktit administrativ te paditesi, data 02.04.2012, perseri ankimi i paditesit për ne Drejtorine e Apelimit Tatimor është brenda afatit 30 ditor.

Gjykata ka vendosur pranimin e padisë duke arsyetuar midis të tjerave se :

Se katërti, gjykata çmon se akti administrativ nr. 1016 date 19.03.2012 i nxjerre nga i padituri Drejtoria Tatimore Rajonale Berat është një akt administrativ i nxjerre ne kundërshtim me ligjin. Ligji konkret me te cilin ky akt vjen ne kundërshtim është pikërisht ligji nr. 9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore ne RSH”.

Nga ana e te paditurve ne aktet e tyre administrative si dhe nga përfaqësuesi i te paditurve ne gjykim, pretendohet se gjoba ndaj paditesit “Pupa” SHPK ne shumën 200000 leke është

vendosur për shkak se ky paditës nuk ka respektuar detyrimin për pajisjen e mallit me kupon tatimor.

Gjykata çmon se rregullat për mbajtjen e dokumentacionit tatimor përcaktohen në ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", në nenin 46 e vijues të tij.

Në nenin 46 pika 1 e këtij ligji parashikohet se "1. Tatimpaguesit, që janë subjekt i TVSH-së ose i tatim-fitimit, për përlogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistrat, dokumentacionin kontabël, librat dhe informacionin financiar, si dhe lëshojnë faturë tatimore, dëftesë tatimore ose kupon tatimor, në përputhje me ligjet e fushës, si dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tyre".

Edhe në nenin 46 të Udhëzimit nr. 24 date 02.09.2008 të Ministrisë të Financave parashikohet se:

46.1 Personi i tatueshëm është i detyruar të mbajë regjistrime dhe të përdorë dokumentacionin tatimor në përputhje me dispozitat e legjislacionit tatimor.

46.1.1 Një person i tatueshëm që ushtron veprimtari ekonomike e tregtare dhe është subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar apo i tatimit mbi fitimin, kur kryen një furnizim mallrash apo shërbimesh, në momentin e furnizimit, është i detyruar të lëshojë faturë tatimore të TVSH-së në lidhje me atë furnizim për çdo person të tatueshëm që merr furnizimin. Personi i tatueshëm që merr furnizimin mund të jetë një person tjetër i tatueshëm subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar apo i tatimit mbi fitimin, një person i tatueshëm subjekt i takses vendore mbi biznesin vogël si dhe një organizatë jofitimprurëse, fondacion, njësi zbatimi projektesh, ent publik kombëtar apo vendor, organizatë politike apo çdo organ tjetër i ngjashëm me të. Forma dhe përmbajtja e faturës tatimore të TVSH-së është siç përcaktohet në Ligjin "Për TVSH" dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij Ligji.

Në lidhje me lëshimin e faturave tatimore ligji nr. 9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" parashikon se:

"1. Shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit. Faturat tatimore përgatitet nga shitësi në jo më pak se dy kopje, nga të cilat njërin e merr dhe e ruan blerësi, kurse tjetrin e mban dhe e ruan shitësi. Faturat përgatiten me numër rendor progresiv.

2. Tatimpaguesi, që mban në ruajtje, përdor apo transporton mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, dënohet, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji.

3. Ministri i Financave, për efekt të llogaritjes së vlerës së gjobës, në përputhje me shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 121 të këtij ligji, përcakton, me udhëzim, mënyrën e përlogaritjes së vlerës së tregut, për mallrat, që janë në qarkullim, të pashoqëruara me faturë tatimore.

Ndërsa Udhëzimi nr. 24 date 02.09.2008 i Ministrisë të Financave në lidhje me shoqërimin me faturë tatimore të mallit që transportohet parashikon sa vijon:

"50.4 Lëvizja e mallrave gjatë transportit shoqërohet me faturën origjinale të shitjes së mallit ose me faturë shoqëruese në rastet e lëvizjes së brendëshme të mallrave, ose në rastin e lëvizjes së mallrave apo paisjeve që janë pjesë e kryerjes së një shërbimi.

50.5 Në rastet kur transporti kryhet me mjete të shitësit ose të blerësit, ky fakt shënohet në pjesën e faturës ku kërkohen të dhënat e transportuesit, si dhe jepen të dhënat identifikuese të mjetit të transportit dhe të shoferit.

50.6 Normalisht data e lëshimit të faturës përputhet me datën e nisjes së transportit. Në rastet kur këto data nuk përputhen, pra kur transportimi i mallit bëhet pas datës së lëshimit të faturës së mallit, ky fakt nuk përbën arësye që malli të bllokohet apo konfiskohet dhe transportimi i mallit nuk pengohet. Kur gjykohet e arësyeshme mund të bëhen verifikime tek shitësi dhe/ose blerësi, ose të informohen drejtoritë rajonale të juridiksionit, të cilat e përdorin informacionin për verifikime apo kontrole të mëvonëshme.

50.7 Në rastet kur transporti i mallrave kryhet nga palë të treta (shoqëri transporti), lëvizja e mallit shoqërohet me faturën e shitjes së mallit, e cila ka të dhëna edhe për transportuesin dhe datën e transportit. Transportuesi gjatë transportimit disponon kopion e parë të faturës me tvsh, e cila i dorëzohet blerësit. Kopio e dytë e faturës origjinale mbahet nga transportuesi.

Si konkluzion gjykata arrin në përfundimin se sistemi tatimor në vend nuk parashikon detyrimin e pajisjes me kupton të mallrave gjatë transportit, kur ato shoqërohen me fature tatimore të leshuar në përputhje me kërkesat e ligjit dhe sipas modelit të kësaj fature të përcaktuar nga Ministria e Financave. Një konkluzion të tillë paraqet dhe shkresa nr. 11700/1 prot. date 28.12.2010 e Ministrisë së Financave, Drejtoria e Politikave Makroekonomike dhe Fiskale, e administruar në gjykim.

Se pesti, gjykata çmon se parregullsitë e sipërpermendura të verëjtura në procesverbalin e konstatimit dhe procesverbalin e denimit me gjobe të dates 26.01.2012 duhet të ishin konstatuar nga vete të paditurit gjatë nxjerrjes prej tyre të akteve administrative objekt gjykimi. Të dy të paditurit kanë patur informacionin e plote zyrtar në lidhje me veprimtarinë ekonomike të paditesit si dhe të dhenat e dërguar prej tij në rrugë elektronike prane të paditurit DRT Berat.

Në rrethanat e mësipërme gjykata konkludon se detyrimi prej 200 000 leke i treguar në aktin administrativ "Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore" nr. 1016 date 29.03.2012 i DRT Berat është një detyrim që nuk rrjedh nga zbatimi i drejte i ligjit.

Aktet administrative objekt gjykimi janë akte administrative që vijnë në kundërshtim me ligjin, pra janë akte administrative relativisht të pavlefshme në kuptim të neneve 115/b dhe 118 të Kodit të Procedurave Administrative.

Për këto arsye në bazë të nenit 324 germa "a" dhe 331 paragrafi i katërt të Kodit të Procedurës Civile, gjykata duhet të vendosë shfuqizimin e dy akteve administrative të sipërpërmendura".

Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur për shkaqet e parashtruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi

Vlerësimi i kolegjit

Kolegji Administrativ i Apelit, çmon se gjykata e shkallës së parë, në kuptim të nenit 16 të K.Pr.Civile, ka gabuar në cilësimin e fakteve dhe veprimeve të lidhura me këtë mosmarrëveshje, duke keqinterpretuar dispozitat e identifikuara për zbatim prej saj, me pasojë zgjidhjen e gabuar të çështjes. Vendimi objekt gjykimi duhet të ndryshohet duke u vendosur rrëzimi i padisë për sa më poshtë vijon:

Gjykata Administrative e Apelit çmon se lloji i pavlefshmerise qe i atribuohet aktit objekt gjykimi, perfaqeson elementin percaktues ne funksion te analizes se pretendimeve te parashtruara ne kerkesëpadi, persa kohe qe ligji njih dy lloje pavlefshmerie te aktit te administrativ, pavlefshmerine absolute dhe relative, ndersa elementet qe provokojne pavlefshmeri ne secilin prej dy rasteve, jane te ndryshme.

Konkretisht, ne Nenin 115 K.Pr.Administrative, parashikohet se:

“Pavlefshmëria e akteve administrative, në kuptimin e këtij Kodi, paraqitet në format e mëposhtme:

a) akte administrative absolutisht të pavlefshme (akte të nxjerra në kundërshtim flagrant me ligjin);

b) akte administrative relativisht të pavlefshme (akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin)”.

Paditësi “Pupa” sh.p.k, rezulton te kete pretenduar, shkaqe pavlefshmerie relative te akteve objekt gjykimi.

Lidhur me pretendimin per pavlefshmeri relative te akteve objekt gjykimi, pala paditese i referohet mosrespektimit nga palet e paditura te dispozitave te Ligjit Nr.9920/2008, ç`ka referon ne kete rast ne Nenin 118/1 te K.Pr.Administrative, sipas permbajtjes se te cilit:

“1.Aktet administrative do të quhen relativisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, kur ato janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin, por megjithatë nuk janë absolutisht të pavlefshme”.

Konkretisht pala paditese ka pretenduar te kunderten e fakteve te pasqyruara ne aktet e inspektoreve tatimore, duke bere me dije leshimin e fatures tatimore ne funksion te dokumentimit te shitjeve ndaj subjektit “Pupa” sh.p.k, dhe likujdimin nga kjo e fundit ne rruge bankare, ç`ka sipas saj e perjashton nga detyrimi i leshimit te kuponit tatimor, duke e bere te pavlefshme edhe masen e ndeshkimit me gjobe.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se aktet objekt gjykimi, nuk permbajne apo nuk u mungojne elemente qe diktojne pavlefshmerine relative te tyre, pasi:

Arsyetimi i gjykatës për mungesen e detyrimit per leshim kuponi tatimor nuk qëndron për arsye ne rastin konkret nuk ekziston asnje rrethane ligjore qe te perjashtoje paditesin nga ky detyrim.

Kolegji i referohet, Nenit 54 te ligjit Nr.9920/2008, sipas permbajtjes se te cilit:

“1. Kuponi tatimor është dokumenti i lëshuar me anë të pajisjeve fiskale apo të pajisjeve të tjera elektronike me aparat shtypshkrimi.

2. Subjektet, që detyrohen të lëshojnë kupona tatimorë, mund të lëshojnë njëherazi edhe faturë, nëse shitja apo shërbimi i kryer është për një përdorim tregtar dhe, për këtë shkak, blerësi është i detyruar ta kërkojë faturën”.

Referuar permbajtjes se dispozites se sipercituar, rezulton se leshimi i fatures tatimore nuk e

zhvesh subjektin tatimpagues nga detyrimi per leshim kuponi tatimor, ne funksion te dokumentimit te sherbimit te kryer.

Pavaresisht sa me siper, ne rastin konkret, edhe nese do te merrej i mireqene ky pretendim, gjykata konstaton se aktet provuese te paraqitura nga pala paditese vertetojne te kunderten e fakteve te pretenduara prej saj.

Per sa me siper, Kolegji administrativ çmon se ankimi i te paditurit Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, permban shkaqe per ndryshim ne favor te tij te vendimit te gjykates se shkalles se pare.

Ne Nenin 56 te Ligjit Nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative", parashikohet se:

"Nuk lejohet rekurs ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Apelit për padi me objekt:

a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi".

Paga minimale, sipas VKM-se Nr.573 Dt.03.07.2013 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", rezulton e percaktuar ne masen 22.000 leke, dyzetfishi i te ciles rezulton ne masen 880.000 leke, nderkohe qe paditesi rezulton te jete ndeshkuar me gjobe ne masen 200.000 leke.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në Nenin 50/c të Ligjit Nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"

VENDOSI

Ndryshimin e Vendimit Nr.1417, datë 22.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Rrëzimin e padisë.

Shpenzime gjyqesore në ngarkim të palës paditëse.

Kundër vendimit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

U shpall sot në Tiranë më 05 .06. 2015.

ANËTARE

Rilinda SELIMI
DV

ANËTARE

Blerona HASA
DV

KRYESUESE

Alkelina GAZIDEDJA
DV

E NJESUAR ME ORIGINALIN
KANCELARI
LEONARD STRATAJ